

Ky dokument nuk është prova. Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

ARTIKULLI

TITULLI	Amedspor befasues në elitën turke, Hasi dhe dy reprezentuesit e Kosovës po ndërtojnë një histori të veç antë
ADRESA	https://albeu.com/sport/amedspor-befasues-ne-eliten-turke-hasi-dhe-dy-reprezentuesit-e-kosoves-po-ndertojne-nje-histori-te-vecante/1011588/
BURIMI	albeu.com
GJENDJA	online

KOHA


KAPUR NGA NE	14 shtator 2026, 19:22:54 UTC <i>Dritarja jonë e pasigurisë: ± 300 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.</i>
DEKLARUAR NGA PORTALI	14 shtator 2026, 19:19:24 UTC <i>Koha e deklaruar vjen nga pala që po vlerësohet. Ora jonë nuk preket prej saj, dhe të dyja shfaqen këtu të ndara.</i>

HASH-ET · SHA-256

PËRMBAJTJA	0363d56fa44d2d362965ec79781cd2aee5e7d7b52d604234494f7c1448a6d049
TEKSTI	0cf2eafc08cf8d9e1a85eedf84eea72857a6e83c435993b84b4475e3b5969b55
PAMJA	4576a49499a7b3bc7cf000384722aaa547ea3ce48f66a19855cfb1dcf708dd6f

ZINXHIRI I PROVËS

KJO HYRJE	79ed4106a0bfb5802e089ae626e551536f40e9fed7bcc47aa5105478607a1e66
E MËPARSHMJA	—
RRËNJA MERKLE	05fd12c73e666390d825ec78dbf996bd3e8990e77e2d97cbe701da17a7d0f007
ANKORIMI	submitted — dërguar, ende pa bllok <i>Deri te blloku, kjo provon integritetin, jo kohën.</i>



SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njërën nga tri gjendjet — **nuk u gjet**, **në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahazo hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

<https://scan.stamles.eu/verify/79ed4106a0bfb5802e089ae626e551536f40e9fed7bcc47aa5105478607a1e66>

PAMJA E FAQES

Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.

Motori: chromium-stored+assets · dritarja 1280×1024 px

Amedspor befasues në elitën turke, Hasi dhe dy reprezentuesit e Kosovës po ndërtojnë një histori të veçantë



Amedspor është shfaqur si një nga surprizat më të mëdha të pesë javëve të para të Superligës së Turqisë. Skuadra nga Diyarbakiri, e udhëhequr nga Besnik Hasi, ka marrë tri fitore, një barazim dhe vetëm një humbje, rezultat që e ka ngjitur në vendin e tretë me 13 pikë.

Për klubin nga juglindja e Turqisë, ky është një sezon historik, pasi për herë të parë po garon në elitën e futbollit turk. Megjithatë, Amedspori nuk është mjaftuar vetëm me pjesëmarrjen në këtë nivel, por që në fillim ka treguar se mund të përballë denjësisht edhe me ekipet më të mëdha të kampionatit.

Arkitekti i këtij starti është Besnik Hasi. Trajneri nga Gjakova ka një karrierë të gjatë në futbollin evropian dhe atë ndërkombëtar, gjatë së cilës ka drejtuar Anderlechtin, Legia Varshavën, Olympiacosin, Al-Raedn, Al-Ahlin dhe Mechelenin. Angazhimi të Amedspori është përvoja e tij e parë në futbollin turk.

Në këtë ecuri kanë pasur rol të rëndësishëm edhe dy futbollistë të Kombëtares së Kosovës, Lumbardh Dellova dhe Ermal Krasniqi.

Dellova dhe Krasniqi kanë qenë titullarë në të pesë takimet e luajtura deri tani, duke u bërë pjesë të rëndësishme të formacionit të ndërtuar nga Hasi.

Mbrojtësi Dellova ka grumbulluar 450 minuta dhe ka dhënë një asistim. Krasniqi, ndërkohë, ka luajtur 439 minuta, vetëm 11 minuta më pak se totali i mundshëm.

Sulmuesi kosovar ka regjistruar dy asistime, duke dëshmuar se ndikimi i tij nuk kufizohet vetëm te faza sulmuese, por shtrihet edhe në krijimin e mundësive për bashkëlojtarët.

Fitorja e fundit ndaj Başakşehirit ishte një tjetër konfirmim i formës së mirë të ekipit. Organizimi, disiplina dhe

të fundit /



QMK: Nga 14 zjarret e raportuara, vetëm ai pranë Borinos vijon t...



Amedspor befasues në elitën turke, Hasi dhe dy reprezentuesit e...



Nagavci: Tërheqja e Sejdiut është humbje për procesin e...



Bekim Sejdiu tërhiqet nga gara për President të Kosovës: Partitë të...



Pas protestave në Serbi, Vuçiq njofton dorëheqjen: Do të...



Ceta kërkon protestë për viktimat e pasluftës në Kosovë: Drejtësia...



Mes birëve të demit 540 kilogramësh për mbi 10 sekonda, Roc...



ARTIKULL JOETIK?

Esim for Global | Esim for Europe | Esim for Caribbean | Esim for USA | Esim for Italy | Esim for Spain | Esim for Turkey | Esim for Germany | Esim for Greece | Esim for Asia | Esim for World Cup 2026 | Esim for Saudi Arabia | Esim for Egypt | Esim for United Arab Emirates | Esim for Balkans | Esim for Morocco | Esim for China | Esim for United Kingdom | Esim for Africa | Esim for Latin America | Esim for GCC Gulf Cooperation Council | Esim for Middle East | Esim for South America | Esim for Canada | Esim for Mexico | Esim for Japan | Esim for Albania | Esim for Kosovo | Esim for Switzerland | Esim for Tunisia | Esim for South Africa | Esim for Algeria | Esim for Portugal | Esim for Brazil | Esim for Argentina | Esim for Colombia | Esim for Hong Kong | Esim for Thailand | Esim for Macau | Esim for Malaysia | Esim for Vietnam | Esim for South Korea | Esim for Austria | Esim for Netherlands | Esim for Australia | Esim for Russia | Esim for India | Esim for Chile | Esim for Peru | Esim for Poland | Esim for North Macedonia | Esim for Sweden | Esim for Finland | Esim for Norway | Esim for Belgium

karakteri i shfaqur në fushë e kanë kthyer Amedsporin në një prej skuadrave më interesante të këtij fillimi të sezonit.

Pas triumfit, Besnik Hasi e vlerësoi lart paraqitjen e lojtarëve të tij. "Për ne është një fitore shumë e madhe. Nuk i lejuam ata të luanin. Ishte një ekip shumë i lëvizshëm, sepse ne i ndalëm. E përgëzoj ekipin tim, morëm një fitore të shkëlqyer", deklaroi ai pas ndeshjes.

Trajneri shqiptar foli gjithashtu për zhvillimin e skuadrës dhe përparimin e lojtarëve, duke veçuar sulmuesin Gift Orban. Sipas tij, Amedspori po përmirësohet nga një ndeshje në tjetrën.

Pavarësisht startit mbresëlënës dhe pozitës së tretë në renditje, Hasi kërkon që ekipi të mos përfshihet nga euforia. Ai e di se sezoni në Superligën turke është i gjatë dhe se rezultatet e para nuk duhet të krijojnë ndjenjën e rehatisë.

"Lojtarët tanë po rriten dhe po vazhdojnë të zhvillohen. Më pas e shijua shumë këtë ndeshje. Por kjo është vetëm një ndeshje, liga sapo ka filluar. Duhet të jemi modestë, t'i mbajmë këmbët në tokë dhe të punojmë shumë", u shpreh trajneri i Amedsporit.

Kjo qasje përmbledh edhe filozofinë e tij në këtë aventurë: sukseset duhen shijuar, por ato nuk duhet të shndërrohen në arsye për humbjen e përqendrimit.

Për legjendën e futbollit shqiptar nga Gjakova, aventura në Turqi po zhvillohet deri tani në mënyrën më të mirë të mundshme. Në krah të tij, Dellova dhe Krasniqi po luajnë role të rëndësishme në një histori që mund të bëhet edhe më e veçantë.

Nëse Amedspori e ruan këtë ritëm, skuadra nga Diyarbakiri mund të mbetet një prej rrëfimeve më interesante të sezonit në futbollin turk.

Shtuar më 14.09.2026 21:19

Tags: Amedspor , Besnik Hasi , Erman Krasniqi , Lumbardh Dellova , shqiptarët nëpër botë , Superliga e turqisë



Rodri: Barcelona duhet të jetë më e disiplinuar në mbrojtje



Liverpooli vëzhgon edhe Alejandro Balde pas marrëveshjes për Araujon



VIDEO/ Jasir Asani ndez Champions-in aziatik, shqiptari shënon me një...



VIDEO/ Como triumfon ndaj Parmës dhe ngjitet përkohësisht në vendin e...



Roma nuk ndalet, katër fitore në katër javët e para pas suksesit ndaj Torinos



Bayern Munich nuk ka bërë ofertë për Rayan Cherkin



Anelotti: Neymar nuk do të rikthehet më në përfaqësuesen e Brazilit



Dembele i përgjigjet Mbappes: Nuk kam qenë kurrë "i zgjedhuri



© 2003 - Albeu Online Media. Të gjitha të drejtat janë të rezervuara!

Kërko...

Kërko

Kryesore

Erion Veliaj
Free Esim

Kategori

Lifestyle
Showbiz

Linqet

Live tv shqiptare
Moti në Shqipëri

Tags

Edi Rama
Albania News

Moti

Moti në Tiranë
Moti në Prishtinë

Pamja këtu është e ri-koduar për ta futur në dokument. Artefakti autoritar është skedari WebP i ruajtur, dhe hash-i i tij është ai i shtypur te faqja e parë — pra dallimi është i verifikueshëm, jo i fshehur.